



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Organi Shqyrtues i Prokurimit
Telo Za Razmatranje Nabavke - Procurement Review Body

Rr. "Migjeni" (ish Banka e Ljublanës), Kati V, Prishtinë 10000, Republika e Kosovës
Tel: +383 (0)38 312 309 - Email: oshp@rks-gov.net

PSH. Nr. 0111/2024

Në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, pas shqyrtimit të ankesës së OE N. P.T. "Haxhijaha" Sh.p.k. kundër Vendimit për anulimin e procedurës së prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me mekanizëm bujqësor Lot.1- Multikultivator Lot.2 - Freza Lot.3- Mbjellëse për grurë Lot.4- Mbjellëse për misër" me numër të prokurimit 634-23-1991-1-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – "KK KLINË" Kryetar i Panelit Shqyrtues Isa Hasani me datën: 21/03/2024, mori këtë:

VENDIM

1.Hedhet si e palejuar, ankesa e OE N. P.T. "Haxhijaha" Sh.p.k me nr. të protokollit 2024/0111, e datës 09.02.2024, ankesë kjo e parashtruar për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me mekanizëm bujqësor Lot.1- Multikultivator Lot.2 - Freza Lot.3- Mbjellëse për grurë Lot.4- Mbjellëse për misër", me numër të prokurimit 634-23-1991-1-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – "KK KLINË", kjo ankesë nuk mund të shqyrtohet, pasi që Operatori ekonomik konsiderohet si palë pa interes juridik material konform nenit 4 paragrafi 1.26 të LPP-së.

2.I lejohet, autoritetit kontraktues – "KK KLINË" që të vazhdoj më tutje me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me mekanizëm bujqësor Lot.1- Multikultivator Lot.2 - Freza Lot.3- Mbjellëse për grurë Lot.4- Mbjellëse për misër", me numër të prokurimit 634-23-1991-1-2-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

3.Në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

-Faktet dhe rrethanat procedurale-

Me datë 10.03.2023, "KK KLINË", ka publikuar B05-Njoftimin për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me mekanizëm bujqësor Lot.1- Multikultivator Lot.2 - Freza Lot.3- Mbjellëse për grurë Lot.4- Mbjellëse për misër", me numër të prokurimit 634-23-1991-1-2-1.

Me 06.10.2023 AK ka publikuar njoftimin B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, për shpërbllim me kontratë.

OE "N. P.T. " Haxhijaha" Sh.p.k me datën 31.01.2024 kishte parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të AK të datës 06.10.2023, ndërsa AK me datën 01.02.2024, ka hedhur si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim të OE ankues.

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 09.02.2024 ka pranuar ankesën me Nr. protokollit 0111/2024 nga operatori ekonomik N. P.T. "Haxhijaha" Sh.p.k lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me mekanizëm bujqësor Lot.1- Multikultivator Lot.2 - Freza Lot.3- Mbjellëse për grurë Lot.4- Mbjellëse për misër", me numër të prokurimit 634-23-1991-1-2-1, iniciuar nga "KK KLINË", në cilësinë e Autoritetit Kontraktues.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Nga provat e prezantuara, për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me mekanizëm bujqësor Lot.1- Multikultivator Lot.2 - Freza Lot.3- Mbjellëse për grurë Lot.4- Mbjellëse për misër" me numër të prokurimit 634-23-1991-1-2-1, iniciuar nga "KK KLINË", konstatohet se njoftimi për kontratë është publikuar në sistemin e-prokurimi me datë 10.03.2023. Operatori ekonomik me të dhënat e cekura si më lartë, me datën 31.01.2024, si pale e pakënaqur me vendimin e AK-së së datës 06.10.2023, ka parashtruar ankesë në OSHP (Protokoll 0111/2024).

Organi Shqyrtues i Prokurimit, pas shqyrtimit dhe realizimit të të gjitha provave dhe shkresave të lëndës, konstaton se për këtë procedurë të prokurimit OE N. P.T. "Haxhijaha" Sh.p.k ka qen i rekomanduar për kontratë më parë në ankesë në OSHP, me numër të protokollit 2023/780, për të cilin OSHP me datën 11.01.2024, ka publikuar vendimin 2023/0780, me të cilin OE ankues është cilësuar si i pa përgjegjshëm lidhur me aktivitetin e prokurimit andaj edhe është eliminuar nga pjesëmarrja.

OSHP pas shqyrtimit dhe analizimit të gjithë dokumentacionit të ankesës dhe procedurës së prokurimit në kontekstin shpjegimeve si me sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu dhe natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, palëve në procedurë u konstatua se ankuesi cilësohet si palë pa interes juridik material, ku nder të tjera vihet në zbatim neni 103 i LPP, sipas të cilit, "Dispozitat e kësaj pjese përcaktojnë të drejtat themelore dhe procedurale dhe mjetet juridike në dispozicion të palëve të interesuara siç është përkufizuar ky term ("pale e interesuar")

në nenin 4 (të këtij ligji)". Kuptimi i kësaj dispozite vërteton fare qartë mendimin e OSHP- së, mjetet juridike mund të vihen në lëvizje vetëm nga palët e interesuara duke ju referuar në këtë rast pikërisht përkufizimit të dhënë në nenin 4 të LPP-së.

Prandaj bazuar në kuptimin e nenit 4, të LPP, lidhur me nenin 103 dhe 111, të këtij Ligji, Paneli shqyrtues konsideron se parashtruesi i saj nuk mund të konsiderohet palë e interesuar dhe se nuk ka nevojë të lëshohet në vlerësimin meritot të pohimeve specifike të kësaj Ankese, sepse të njëjtat janë jo lëndore në kuptim të nenit 111 të LPP dhe për këtë çështje juridike janë dhënë vendimi me Nr.2023/0780 me datën 11.01.2024, me të cilin duke u bazuar në rekomandimin e ekspertit ka kthyer aktivitetin e prokurimit në fjalë në rivlerësim ndërsa OE i rekomanduar për kontratë konsiderohet i pa përgjegjshëm sepse i njëjti nuk ka plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit. Pra, në bazë të vendimit 780/23 konsiderojmë se "Haxhijaha" SHPK – LOT 1 është rekomanduar për kontratë nga ana e AK duke qenë OE i pa përgjegjshëm.

Pas vlerësimit dhe administrimit të të gjitha provave përkitazi me këtë procedurë të prokurimit, OSHP konsideron se ankesa e OE ankues e pranuar në OSHP me datën 09.02.2024 është e palejuar sepse e njëjta është çështje e gjykuar "Res Judicata" më parë dhe për të njëjtin tashmë është marrë vendim.

Nga të gjitha sqarimet e cekura si më lartë, OSHP e hedhë si të pa lejuar ankesën e parashtruar me datën 09.02.2024 me nr. protokollin 0111/2024 nga operatori ekonomik N. P.T. " Haxhijaha" Sh.p.k sepse ankesa për këtë procedurë të prokurimit, konsiderohet çështje e gjykuar sipas paragrafit 2.16 të nenit 105 të Ligjit për Prokurim Publik, ku thuhet: "*Në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar "res judicata", dhe konfirmoj nën 4, 1. 26 të ligjit, OE ankues N. P.T. " Haxhijaha" Sh.p.k me emrin tregtar konsiderohet si palë pa interes juridik për shkak se me vendimin 780/23, i njëjti është konsideruar si i papërgjegjshëm, prandaj Ankuesi nuk mund të arrijë të dëshmojë se ka statusin e palës së interesuar sipas dispozitës 4, 1.26 të LPP-së.*

Autoriteti kontraktues – "KK KLINË", mund të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit (e përshkruar më sipër) nëse nuk ka ankesë tjetër për këtë aktivitet. Organi Shqyrtues i Prokurimit i vë në dijeni se në çdo aktivitet AK duhet të veprohet konform dispozitave dhe autorizimeve ligjore siç përcaktohen ato me nenin 1, 6, 7, 27, 28, 59, 60, 65 të LPP.

Duke qenë se OE ankues me rastin e parashtrimit të ankesës ka paguar tarifë, e njëjta konform nenit 31, par 4 të Rregullores së Punës së OSHP-së, i kthehet OE ankues. I njëjti obligohet që kërkesën për kthim të mjeteve ta parashtrorë brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve sipas nenit 31 par 6 të rregullores së cituar më lartë.

Kryetari i PSH-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani



Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur, me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK – KK.KLINË
- OE - N. P.T. " Haxhijaha" Sh.p.k.
- Arkivës së OSHP-së: